



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Fizioterapi”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit
“Aleksandër Xhuvani”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Irena Saço Kola

2. Prof. As. Enkeleda Sinaj

Korrik/ 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Paraklinike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Fizioterapi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH nr.432, datë 10.09.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 61, datë 31.05.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cilki i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	26 PAE/ 15 PAK
18	Numri i studentëve:	242 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" është një program studimi i ciklit të parë, i cili ofrohet pranë departamentit të Lëndëve Paraklinike, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", që prej vitit 2012. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të parë Bachelor në "Fizioterapi". Ky program synon formimin e specialistëve fizioterapistë, kurrikula e të cilit mundëson pajisjen me njohuritë themelore teorike dhe praktike të studentëve, prezantimin me praktikat bashkëkohore europiane dhe eksperiencën shqiptare në fushën e fizioterapisë, duke aftësuar studentët t'u përgjigjen kërkesave aktuale dhe prespektive për punësim në këtë sektor dhe të jenë konkures në tregun ndërkombëtar të punës.

Në mbështetje të programit të studimit, Universiteti ka ngritur sallat e procesit mësimor dhe laboratorët për zhvillimin e lëndëve bazë, posaçërisht Laboratori i Fizoterapisë i pajisur me shtetërit e manipulimit, shkallët suedeze, Tens-in, Ultratingull-in, Laser-in, Infrared-in, topa, pesha, pista, biçikleta statike etj., për vënien në praktikë të njohurive teorike. Universiteti e mbështet programin e studimit, edhe nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione dhe qendra spitalore, më konkretisht: Qendra Spitalore Rajonale "Xhaferr Kongoli", Qendra Balashe, Spitali Psikiatrik dhe Shkolla speciale "Zëra Jete", kryesisht për realizimin e praktikave mësimore.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën Grup ekspertësh: Prof. Asoc. Irena KOLA dhe Prof.Asoc. Enkeleda SINAJ, si ekspertë të jashtëm të vlerësimit për këtë program studimi.

Ekspertët e vlerësimit, bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UNIEL dhe në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr.41, datë 24.01.2018, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, kanë kryer vlerësimin e jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”.

Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga UNIEL për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike në datën 23-24 Janar 2023. Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, drejtuesit e Fakultetit, Departamentit, grupin e punës dhe stafin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

Takime u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të: Burimeve Njerëzore, Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra për Kujdesin ndaj Studentëve, Sekretarinë mësimore si dhe vizitë në Bibliotekën e Universitetit.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas rubrikave përkatëse. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”, ofruar nga Unviersiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Më datë 07/07/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/98 Prot., datë 10/07/2023, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. UE kthehu përgjigje me shkresë zyrtare Nr. 642/86 Prot., datë 18/07/2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”

I. OFRIMI PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me strategjinë institucionale të UNIEL, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Fizioterapisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale dhe ato të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe atyre të Departamentit Paraklinik. Programi promovon formimin akademik dhe shkencor bashkëkohor të studentëve mbështetur në prioritetet strategjike përkatëse, që lidhen me përgatitjen e fizioterapistëve me njohuri të përgjithshme dhe në fushën e fizioterapisë duke filluar që nga teoritë bazë dhe thellimin e tyre. Kjo parashikohet dhe në nenin 2 të Statutit të UNIEL <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Duke analizuar Statutin dhe Misionin e UNIEL, në vlerësimin tonë konfirmojmë se programi i studimit është në përputhje të plotë me qëllimin dhe misionin e tij, si dhe me fushën e veprimtarisë, të rregulluara edhe në aktet e brendshme të tij, të cilat synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare në përgatitjen e fizioterapisteve të ardhshëm. <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Referuar Statutit të UNIEL, programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është në përputhje me misionin dhe fushën e veprimtarisë të tij. Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UNIEL. Nga analiza e dokumentacionit të përgatitur nga Institucioni, GVJ konstatoi se programi i studimit “Fizioterapi” është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe me fushat e drejtimeve akademike institucionale. <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UNIEL është institucion i arsimit të lartë themeluar me VKM nr. 414 datë 12.11.1991. Duke analizuar aktivitetin akademik të deritanishmë mund të themi se, IAL-i ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”. <i>EVIDENCA 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional.</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të	Programi Bachelor në “Fizioterapi” jep dije dhe aftësi të profilizuara, gjithashtu është i ndërthurur edhe me dije multidisiplinare. Fusha të

<p>studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>përgjithshme dhe fusha specifike janë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknik si dhe secila prej tyre është e kodifikuar. <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe vizitës në aktivitet. Programi i Studimit është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e IAL, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UNIEL.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi I.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, konstatoi se UNIEL nuk ka paraqitur asnjë evidencë të qarte ku të pasqyrohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit, ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit apo strukturën e programit të studimit. Ne dokumentacionin shqyrtues paraqitet <i>evidenca nr. 3.19 Struktura e programeve te studimit te FSHMT,</i> e paqarte. <i>Në të pasqyroheshin vetem kalendari i periudhes mësimore dhe praktikave, por asnjë informacion lidhur me ndarjen e detyrave midis njesive dhe personelit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për arritjen e objektivave të procesit mësimor, institucioni liston historik të marrëveshjeve të ndryshme bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave sigurohet përfitim për studentët dhe personelin, por ato nuk janë paraqitur të detajuar në dokumentacionin shqyrtues. <i>EVIDENCA 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e</p>	<p>Ne dokumentacionin shqyrtues janë listuar marrëveshjeve të ndryshme bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave sigurohet përfitim tek studentët për realizimin e praktikave mësimore, por ato nuk janë vënë të detajuara me kontrata apo marreveshje të nënshkruara , në dispozicion të GVJ. Institucioni nuk ka paraqitur nje plan specifik tregues per zhvillimin dhe shperndarjen e praktikave neper institucione te specializuara.</p>

praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<i>EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Lëndëve Paraklinike harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto të dhëna pasqyrohen në mbledhjet periodike të departamentit si dhe janë pjesë e analizës vjetore të tij. <i>EVIDENCA 1.34 Analiza vjetore e departamentit të Lëndëve Paraklinike për vitin akademik 2021 -2022.</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjate vizitës. IAL ka krijuar Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit, në lidhje me modelimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e tij. Gjithashtu, UNIEL liston historik të marrëveshjeve të ndryshme bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit tonë, por nuk I paraqet ato te detajuara. UNIEL nuk ka paraqitur asnje evidencë të qarte ku të pasqyrohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit, ndarjes së detyrave mes njësive e personelit apo strukturen e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ vlerëson se kurrikula e programit të studimit BA në Fizioterapi është e organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të Programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E, por jo në përputhje me VKM 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Lëndët e kategorive C zënë vetëm 6.6% të ngarkesës në program dhe jo 12%-25% sa paraqitet në udhëzimin. Gjithashtu lëndet e kategorive D zënë një peshë prej 19.5% në planin mësimor të UNIEL dhe jo sa udhëzohet.</p> <p>Programi i studimit si çdo program Bachelori ka një kohëzgjatje prej 3-vitesh akademike me 180 ECTS. Zhvillohen gjithsej 51 lëndë të ndara në 3 vite akademike ,19 lëndë në vitin e parë, 15 lëndë në vitin e dytë, 17 lëndë në vitin e tretë. GVJ konstatoi se në planin mësimor paraqiten qartë lëndët dhe ndarja për secilën prej tyre në leksione, seminare, laboratore, orë praktike, si dhe provimi i përgjithshëm përfundimtar me kreditet përkatëse, ku një krediti të studimeve universitare i korrespondojnë 25 orë mësimore dhe pune të studentit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi përmban lëndë dhe module të cilat synojnë formimin e studentit si profesionist me njohuri bazë dhe specifike bazuar në metoda e parime shkencore si dhe në metodologjinë moderne të rehabilitimit duke ndërthurur formimin teorik e praktikë.</p> <p>Nga UNIEL nuk është bere një analize e sakte per tregun e punës në vendin tone, ku të dallohet nevoja për profesioniste në fushen e shkencave rehabilituese.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”.</i></p>

specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi", ka të përcaktuar veprimtaritë formuese, duke grupuar modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën respektive në kredite. Ne planin e studimit te programit përqindja totale e lëndëve përkategoritë A dhe B respekton limitin >70%, e specifikuar ne aktet ligjore ne rastin Bachelor, ndersa kategorit C dhe D nuk e respektojne limitin e vendosur. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit në "Bachelor në Fizioterapi".</i> <i>EVIDENCA 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidenca 3.16. Plani mësimor i programit të studimit .</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planin mësimor të këtij programi studimi janë të përcaktuara ngarkesat në kredite për realizimin e praktikave mësimore, gjithsej 30 kredite, ndarë në 6 semestra në 3 vite akademike. IAL në dokumentacionin shqyrtues liston vendet e zhvillimit të praktikës, por bashkëpunimet me institucionet ku kryen nuk tregohen te detajuara me kontrata apo marreveshje të nënshkruara. Institucioni nuk ka paraqitur nje plan specifik tregues per zhvillimin dhe shperndarjen e praktikave neper institucione te specializuara. Gjithashtu në këtë program studimi është përcaktuar forma e detyrimeve përmbyllëse, e cila është me provim mbrojtje temë diplome. <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik konstatoi se syllabuset, përgatiten nga titullarët e lëndëve dhe përmbajnë të gjithë elementët sipas legjislacionit në fuqi. Neni 5 i Rregullores së programit paraqet kriteret dhe procedurën e pranimit të studentëve duke respektuar kuadrin ligjor. Bordi i UNIEL vendos dy modele financimi të studentëve nëpërmjet bursave dhe përjashtimit nga tarifat e studimit si dhe dy kategori financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kriterëve të tjera të vendosura. Megjithatë, në dokemntacionin në dispozicion nuk u paraqit asnjë evidencë ku te detajohej levrimi i fondeve për këto financime. <i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi".</i> <i>EVIDENCA 1.8. Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Gjatë vlerësimit tonë u kontaktua se programi i studimit "Bachelor në Fizioterapi" në UNIEL ka një ngjashmëri në përmbajtje deri në 70 % me programet e studimit të ngjashme "Bachelor në Fizioterapi" të ofruara nga Fakulteti i Shkencave Mjekesore në Universitetin e Tiranës. Lendet, emertimi i tyre është konform degeve të mjekesise, shperndarja e tyre shpreh nje synim te programit qe ne fillim të viti të pare, lendet japin

	<p>njohurite e përgjithëshme bazë për te vazhduar më tej në specialitet, cka në vitin e dytë e të tretë shton peshën e lëndëve profesionale, orët në laborator, e orët e praktikës.</p> <p><i>EVIDENCA 3 .17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>			
<p>Kriteri 7.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>GVJ konstatoi se çdo lëndë, modul që zhvillohet në programin e studimit “Bachelor në Fizioterapi” është i pajisur me një kod unik, i cili korrespondon midis planit mësimor dhe syllabuseve.</p> <p><i>EVIDENCA 3 .17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentacioni shqyrtues si dhe vizitës në aktivitet u konstatua se, UNIEL nuk aplikohen programe studimi të përbashkëta me institucione të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës në ambientet e UNIEL. Programi është i organizuar me lëndë të vlerësuara në kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Cdo modul që zhvillohet në programin e studimit është i pajisur me një kod unik, i cili korrespondon midis planit mësimor dhe syllabuseve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>FSHMT është njësi kryesore e UNIEL. Autoritetet udhëheqëse akademike janë Dekani dhe Drejtuesit e Departamenteve. Dekanati është organi kryesor akademik i fakultetit dhe Departamenti i Lëndëve Paraklinike është njësia bazë përgjegjëse për programin. Grupi i Vlerësimit gjykon se njësia kryesore për programin Bachelor në Fizioterapi përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe vlerësimin e akreditimit. <i>Për sa i takon stafit akademik gjykojmë se është e nevojshme të këtë rekrutime te reja nga UNIEL me titujt e gradat e nevojshëm e përvojë në mësimdhënie. Nga analiza e personelit rezulton se lëndet karakterizuese të programit mbulohen kryesisht nga personel i pa kualifikuar me gradat e nevojshme, mbizotrojnë tituj Msc.</i></p>

	<p>Njësia kryesore ka në përbërjen për vitin akademik 2021-2022, 10 anëtarë personel akademik -PAE: 1 personel akademik me titullin akademik "Profesor i asocuar", 4 personel akademik të kategorisë "Lektor" me gradë shkencore "Doktor i shkencave", 1 docent dhe 4 asistentë lektorë me gradën Master i Shkencave. Gjithashtu në përbërjen e tij departamenti ka të përfshirë në mësimdhënie edhe 1 anëtar personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën Master Shkencor. Në personelin akademik me kohë të pjesshme departamenti ka 1 anëtar me titullin akademik "Prof.as.dr.". Dr, 2 me gradën "Doktor i Shkencave" dhe 17 asistentë lektorë me gradën Master Shkencor.</p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.18 Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik në kuadër të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.18 CV e personelit akademik të përfshirë në programin</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Praktika mësimore, kryhet në kabinetin e Fizioterapisë për realizimin e programit të studimit. Gjithashtu IAL liston marrëveshje bashkëpunimi me Spitalin Psikiatrik dhe Spitalin Rajonal të Elbasanit. Përgjegjësi i njësisë bazë (Departamenti i Lëndëve Paraklinike) është koordinatori akademik. Ai bën ndarjen e punës për personelin e ndjekjes së praktikave profesionale për secilin shërbim shëndetësor.</p> <p>Nga dokumentacioni shqyrtues GVJ konstatoi se studentët ndahen në grupe të vogla në reparte dhe javë të ndryshme sipas planit mësimor dhe strukturës së vitit akademik.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke angazhuar nje personel ndihmës akademik për realizimin dhe ndjekjen e praktikave mësimore.</p> <p><i>EVIDENZA 1.13 Lista e marreveshjeve per zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17. Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.7. Rregullore e FSHMT</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se FSHMT si njësi kryesore e UNIEL përbëhet nga Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekësore të cilët funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë, të përcaktuar në rregulloret përkatëse.</p> <p>Mbështetur në organizimit dhe funksionimin të veprimtarisë në departamentin e Lëndëve Paraklinike dhe në realizimin e detyrimeve ligjore me vendim nga përgjegjësi i departamentit të Lëndëve Paraklinike date 17.01.2019, emerohet koordinatori, i cili koordinon punën për hartimin e strategjisë së zhvillimit të programit, rregullores së programit,</p>

	<p>dokumentacionit që përfshin të gjithë elementët e programit dhe praktikat profesionale. Gjithashtu ndjek ecurinë e regjistrimeve dhe transferimeve të studentëve, monitoron realizimin e projekteve.</p> <p><i>EVIDENCA 1.24 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues si dhe takimeve me stafin gjatë vizitës në ambientet e UNIEL. Njësia kryesore për programin "Bachelor në Fizioterapi" përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe vlerësimin e akreditimit..</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga biseda me stafin akademik të Departamentit Paraklinik vlerëson se ai zotëron njohurit e duhura, aftësi dhe kompetenca të nevojshme në lidhje me programin mësimor Bachelor në Fizioterapi. Departamenti ka informacionet dhe dokumentat e nevojshme për të gjithë elementet e programit të studimit: rregullore, planet mësimore, numrin dhe ngarkesën mesimore të çdo pedagogu, organizimin e praktikave profesionale, orarin mësimor, strukturën e vitit akademik, kalendarin e provimeve, etj.</p> <p><i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ gjykon se programi i studimit Bachelor në Fizioterapi është i organizuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Ai është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik. Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, e cila përfshin ngarkesën në orë në auditor, që zënë komponentët mësimorë, leksionet, seminarët, laboratorët, praktikat, forma e kontrollit të vazhduar, etj. Orët në auditor dhe orët jashtë auditorit së bashku përbëjnë sasinë mesatare të punës së kryer nga një student gjatë një viti studimi, që është 60 kredite x 25 orë mësimore për kredit 1500 orë mësimore punë të studentit, të cilat</p>


	<p>përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhdueshëm është deri në 25 orë mësimore nga 50 minuta secila. Kreditet që i korrespondojnë çdo veprimtarie formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin perfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhduar me atë përfundimtar. Rregullat për frekuentimin dhe ndjekjen e programit, si dhe vlerësimin e njohurive përcaktohen në rregulloren e programit, si dhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8. Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>I gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve është pasqyruar në Rregulloren e UNIEL. FSHMT për çdo vit akademik përcakton kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve të cilat i përcjell në Rektorat për t'u miratuar më pas në Senatën Akademik të UNIEL. Bazuar në rregulloren e njësisë kryesore, kriteret bazë për pranimin e studentëve janë: studentët që kanë një diplomë të shkollës së mesme ose një diplomë ekuivalente, si dhe mesataren të përcaktuar me VKM.</p> <p>Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve konform nenin 74, të ligjit nr. 80/2015, Udhëzimit të MASR-së. Çdo vit akademik, departamenti i Lëndëve Paraklinike përcjell për miratim propozimet për kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve në programet që ofron, kuotat e transferimit të studentëve në UNIEL, bazuar në kapacitetet pritëse dhe akademike.</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL.</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Komiza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të</p>	<p>Përmbajtja e syllabuseve të lëndëve në program kanë elementët e përcaktuar nga VKM Nr.41/2018, Shtojca Nr.2 si: titullari, ngarkesa, tipologjia. Metodat e mësimdhënies dhe format e vlerësimit të studentit janë të përshtatshme për çdo lëndë dhe në raporte të duhura sipas lëndës, përmbajnë informacionet e nevojshme të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe seminarëve, orët brenda dhe jashtë auditorit. Literatura e pasqyruar në syllabuse nuk është e azhurnuar me botime recente. Programet si në strukture</p>

<p>programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>dhe përmbajtje, janë të kuptueshme, mund të përballohen nga studentët dhe tu japin atyre një formim bashkëkohor të fizioterapeutit. Gjithashtu syllabuset e lëndëve përcaktojnë strukturën e notës përfundimtare bazuar në totalin e vlerësimeve për testet paraprake, kolokiumet, detyrat, projektet dhe provimin final.</p> <p><i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit " Bachelor në Fizioterapi".</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e Departamentit GVJ gjykon se, UNIEL synon të mundësojë përmirësimin e programeve të studimeve nëpërmjet personelit akademik në përputhje me aktualitetet shkencore si dhe të modifikojë kur e sheh të arsyeshme metodologjinë e mësimdhënies për të përmirësuar nivelin e përfitimit nga studentët.</p> <p>Per përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies ky institucion në fund të çdo viti akademik bëhn rishikimi të programit të studimit, ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në përmbajtje të syllabuseve - duke përfshirë stafin akademik, studentët e programit, etj. Ndryshimet e propozuara kalojnë për miratim në Senatit Akademik dhe i përcillen për njoftim MASR ku nuk e kalojnë 20% të masës së ndryshimeve në program.</p> <p><i>EVIDENCA 1.33 Analiza vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike 2019 - 2020, 2020-2021.</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi").</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi për vitin akademik 2021 -2022.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht, referuar analizës të dokumentacionit shqyrtues dhe nga biseda me stafin akademik të Departamentit Paraklinik. Programi i studimit është i ndarë në lëndë, module, praktikë dhe aktivitete formuese të cilat zhvillohen në 3 vite akademike, në 6 semestra në total dhe 2 semestra në secilin vit akademik. Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm në lidhje me ngarkesën mësimore, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi për programin e ciklit të parë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Lendet, përmbajtja dhe emërtimi i tyre është konform degeve të mjekesise dhe fushave qe ato perfaqsojne. Shpërndarja e lëndëve shpreh qëllimin e programit, që në fillim të vitit të pare lendet si anatomi, terminologji, histologji, biokimi mjekësore, etj, japin njohurite e përgjitheshme bazë për tu futur më tej në specialitet, në vitin e dyte e të tretë shton numrin e lëndëve profesionale dhe orët e praktikës.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit gjykon se mënyra e ndërtimit dhe organizimit cilësor të programit Bachelor ne Fizioterapi në UNIEL e jep mundësinë e arritjes së objektivave formuese dhe rezultateve te pritshme të të nxënit që synon ky institucion tek studentët.</p> <p>Vlersojmë se ndërthurja e lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike në program, përmirësojnë formimin profesional të studentëve, të cilët bëhen të aftë për të punuar në specialitete të ndryshme.</p> <p><i>EVIDENCA 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti i formimit teorik me atë praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor qoftë të IAL në vendin tonë qoftë edhe me programet ndërkombëtare. Programi është i organizuar në 3- vite akademikë dhe në 180 kredite. Studentët shpenzojnë gjithsej: Leksione: 1050 orë, Seminare:418 orë, Laborator: 768orë</p> <p>Studim individual: 2264 orë. Praktikë profesionale: 600 orë dhe Diploma:10 Total: 5110 orë.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblylëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p> <p><i>Ndërsa po ti referohemi kategorive të lëndëve plotësuese dhe përmblylëse, programi nuk është në përputhje të plot me peshat e paraqitura në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 në shpërndarje të ngarkesave.</i></p> <p>Megjithatë ne vlerësojmë se peshën më të madhe në programin Bachelor në Fizioterapi e kanë lëndët karakterizuese, pasi ato i përgjigjen kompetencave që synon programi, në formimin e specialistëve në fushën e fizioterapisë.</p> <p>Në program leksionet zenë rreth 20% të orëve dhe pjesa tjetër (seminare e praktikë profesionale) 80% të orëve. Ky raport shpreh qartë synimin për formim profesional të këtij program studimi. Në këtë këndvështrim mundësohet arritja e objektivave formuese, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>



<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik konstatoi se programet e moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse. <i>Nga analiza e cdo syllabusi vënë në dispozicion nga IAL, u vu re mungesë e literaturave bashkohore në fushën e fizioterapise.</i> Titullari i lëndës ka detyrimin të hartojë në kohën e duhur syllabuset, në përputhje me planin mësimor, një kopje e të cilit dorëzohet në departament dhe firmoset nga përgjegjësi i departamentit. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>		
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin Bachelor. Referuar programit me lëndët respektive në çdo semestër, njohuritë vijnë duke u thelluar dhe zgjeruar nga një semestër në tjetrin. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Në këtë mënyrë synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe klinike. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>		
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi u jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem Bachelor, i ndihmon ata për studime të mëtejshme të avancuara, si dhe ndihmon në rritjen e ambicieve të studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. <i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në aktivitet. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti i formimit teorik me atë praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor në vendin tonë si dhe me programet ndërkombëtare. Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara në nivelin Bachelor dhe i ndihmon studentet për studime të mëtejshme të avancuara. Gjithashtu ndihmon në rritjen e ambicieve të studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi II.5				
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Në dokumentacionin shqyrtues UNIEL liston bashkëpunime me institucione të ndryshme. Këto bashkëpunime synojnë të përgatisin specialistë të aftë profesionalisht, në gjendje t'i përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit, duke ju ofruar studentëve fleksibilitet në njohuritë e përftuara në këto institucione. Në përshtatjen ndaj kërkesave të tregut, <i>Departamenti ofron edhe programe të ciklit të dytë, master profesional në Fizioterapi, por ai nuk paraqet një studim të mirefilltë të studimit të tregut të punës dhe të punësuarve nga studentët e diplomuar në UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" për vitin akademik 2021-2022)</i> <i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ gjatë takimit me studentët konstatoi se UNIEL nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre duke i angazhuar dhe në Senatin Akademik. Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Ata konsiderohen si një burim i nevojshëm për të marrë sugjerime në funksion të rishikimit të programit dhe rritjes së cilësisë së zhvillimit të procesit teoriko-praktik. <i>EVIDENCA 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstatoi se njësia përgjegjëse përmirëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me të tretë. E vetmja evidencë e parqitur i takon ndryshimit në emërtim dhe në ngarkesë të dy lendeve Biologji e Përgjithshme dhe Neurologji-Psikiatri udhëzimeve të dhëna nga rektorati dhe dekanati. <i>EVIDENCA 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se ky standard përmbushet kryesisht pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe vizitës në aktivitet. IAL ofron programin Bachelor në përshtatjen ndaj kërkesave të tregut, por ai nuk paraqet një analizë të mirëfilltë të studimit të tregut të punës dhe të punësuarve nga studentët e diplomuar. GVJ nuk i'u paraqit ndonjë evidence mbi kontaktet dhe konsultimet me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Bazuar ne programin mesimor, GVJ gjykon se UNIEL garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat e nevojshme. Format e Mësimdhënies jane: leksion, seminar, ushtrimet, labororet, praktika mesimore, detyrat e kursit etj. Në mbështetje të procesit të mësimdhënies departamenti organizon dhe ndarjen e praktikës mesimore në institucione të ndryshme, si pjesë lëndore e planit mesimor për këtë program studimi. <i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL, EVIDENCA 3.16 Plani mesimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik ne UNIEL angazhohet për të ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit Bachelor në përgjithësi dhe specifikisht per module te vecanta gjithashtu është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Në viteve akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, gjatë mbylljes së ambienteve të institucioneve për shkak të pandemisë, u praktikuan metodat alternative të mësimdhënies/nxënies ku rezultuan relativisht efikase sic është mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams. <i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin akademik konstatoi se UNIEL mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelet akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë është një metodë fleksibël që u perdorë gjerësishtë gjatë pandemisë. <i>EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik më së shumti vjen nga përvoja akademike në vende të ndryshme dhe me përvojë të gjatë profesionale, çfarë i mundëson atij të zotërojë njohuritë e nevojshme në funksion të përmirësimit të programit. Përgjegjësi i departamentit organizon kontrole periodike të mësimit duke dhënë vlerësime të kompetencës së pedagogëve për lëndët që ofrojnë. Përdorimi i platformës Teams në mbështetje të mësimdhënies online gjatë periudhës se pandemisë së COVID-19 ka siguruar mundësi të mira si për pedagogët dhe ashtu për studentët për zhvillimin me cilësi të procesin mesimor. Kjo u konstatua dhe nga bisedat me stafin dhe studentët. Personeli akademik i angazhuar në këtë program siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë pedagog-student <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" për vitin akademik 2021-2022)</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.33 Analiza vjetore e FSHMT 2021 -2022</i></p>		
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Lëndëve Paraklinike – njësia bazë është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi përmes vlerësimit sistematik të formave dhe metodave të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e tyre të vazhdueshëm, në funksion të rritjes së efikasitetit të mësimdhënies. Studentët janë pjesë integrale e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies. Përmes anketimeve të zhvilluara merren mendimet e tyre për këtë proces, mendime dhe ide të cilat reflektohen në format e mësimdhënies. Rezultatet e pyetësorit përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit në mësimdhënie. Instrument tjetër që përdoret është organizimi i trajnimeve të ndryshme nga njësia bazë apo rektorati, me qëllim reflektimin e kërkesave për përmirësim të metodave të mësimdhënies.</p> <p><i>EVIDENCA 3.13 Infomacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UNIEL ka në përbërje të tij strukturë ndihmës akademike me funksion koordinimin institucional, kërkimit shkencor dhe projektet. Struktura ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personleve akademike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Konkretisht është krijuar figura e koordinatorit duke synuar që nëpërmjet tij të promovohet përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies, koordinimi dhe bashkërendimi me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>EVIDENCA 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.25 Vendimi për caktimin e koordinatorit</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. UNIEL garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimdhënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat e nevojshme. Stafit akademik në UNIEL angazhohet në përmirësimin e formave e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e departamentit përcaktojnë qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve. Praktika e punës në institucion është konform detyrimeve ligjore lidhur me informimin e studentëve mbi metodologjinë e vlerësimit. Të gjithë studentët informohen në mënyrë të detajuar në orët orientuese, në stendën e fakultetit dhe në faqen zyrtare të UNIEL. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi</i> <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vetë përmbajtja e detajuar dhe e strukturuar e syllabuseve sipas standardeve përcaktojnë mënyrat dhe metodologjinë e testimit dhe të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore për studentët. Syllabuset respektojnë të njëjtin format dhe sikurse rezultoi nga biseda me stafin akademik ato prezantohen në fillim të çdo lënde nga titullari i saj. Takimi me studentët e konfirmoi një praktikë të tillë për tri vitet e studimit. <i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi".</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Referuar Rregullores së departamentit njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre, vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, provim kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim. Në përfundim të lëndës, çdo pedagog njofton studentët për vlerësimin dhe sasinë e pikëve para hyrjes në provimin final. Informimi i studentëve për rezultatet përfundimtare kryhet nëpërmjet sistemit EMS brenda 6 ditëve nga provimi përfundimtar. <i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.17. Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamentit të Lëndëve Paraklinike zhvillohet një proces vlerësimi për metodologjitë e mësimdhënies, që përfshin në të edhe studentët, duke marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre. Këto metodologji miratohen nga pedagogët që përfshijnë edhe studentët me ballafaqime të ndryshme për pëtmirësimin e kurrikulave. <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.34 Analiza vjetore e departamentit të Lëndëve Paraklinike për vitin akademik 2021 -2022</i> <i>EVIDENCA 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe	UNIEL mbështet personelin e tij në përdorimin e metodologjive inovatore, që ndihmojnë studentët të përmirësojnë kompetencat e reja dhe të përmbushur kërkesat e tregut të punë dhe kërkesat e punëdhënësve. Personeli akademik gjatë mësimdhënies përdor metoda të ndryshme dhe fleksible për studentët. Mësimdhënia në distancë është një metodë fleksibel që u përdorë gjerësisht gjatë pandemisë.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 20

<p>kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p><i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen qartë në Rregulloren e programit të studimit. Njohuritë e studentëve sipas lëndëve dhe specifikave të tyre, vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim. UNIEL mbështet personelin e tij në përdorimin e metodologjive inovatore, që ndihmojnë studentët të përmirësojnë kompetencat e reja dhe të përmbushur kërkesat e tregut të punë dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë sin e ankimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë takimeve u konstatua se njohuritë e studentëve sipas lëndëve vlerësohen duke u bazuar në vlerësimin për detyra, kontrollit të vazhdueshëm, prezantime, projekte e provim përfundimtar dhe pjesëmarrje aktive në mësim. Në përfundim të lëndës, çdo pedagog njofton studentët për vlerësimin dhe sasinë e pikëve para hyrjes në provimin final. Informimi i studentëve për rezultatet përfundimtare kryhet nëpërmjet sistemit EMS brenda 6 ditëve nga provimi përfundimtar. Kjo mënyrë e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><i>EVIDENCA 3.15. Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ u njoh nga drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundatio) se IAL po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: "clean scoring". Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme si në nivelin bachelor dhe master. Gjatë pandemisë së COVID19, mësimi i semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 u zhvillua online dhe pedagogët proceduan me vlerësimin e vazhduar të</p>

	studentit online në platformat elektronike në Google Classroom/Teams. <i>EVIDENCA 3.6 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi duke garantuar vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Pasqyrimi i vlerësimit përfundimtar të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike (EVIDENCA 4. 11 Rregullorja EMS</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përgjatë vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, në varësi nga natyra e lëndës, pas çdo provimi komisionit të provimit i kërkohet t'i shpjegojë studentit vlerësimin e bërë dhe nëse provimi është edhe në formë të shkruar, të ballafaqojë përgjigjet e studentit me tezën e zgjidhur, duke e ndihmuar të përmirësohet në të ardhmen. Gjithashtu, sistemi elektronik EMS i jep mundësi pedagogut të jetë transparent në mënyrë që studentit të jetë më i qartë në vlerësimin që ka marrë. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. Këto detyrime parashtrihen në rregulloret e Institucionit dhe Kodin e etikës, të cilat pasqyrojnë penalitetet për raste të tilla <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Gjatë takimit me stafin akademik dhe me studentët, GVJ konstatoi se provimet dhe testimet me studentët bazohen në kontrollin e dijeve dhe rezultatet e tyre hidhen në sistemin elektronik EMS brenda 6 ditëve. Hedhja në sistem garanton transparencë dhe siguri, si dhe respekton të dhënat personale. Procedurat janë të parashikuara në aktet rregullatore të institucionit dhe të programit të studimit BA në Fizioterapi. Dokumentet e provimit të studentëve ruhen për 6 muaj në përputhje me rregulloren. <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtat për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët kanë të drejtë të shikojnë personalisht provimin në prezencë të pedagogut të lëndës, për të marrë sqarimet e duhura. Për sqarime të mëtejshme ata kanë të drejtë t'i drejtohen me shkrim Dekanit të Fakultetit. Në rast ankimimi, njësi bazë ngre komisionin e shqyrtimit të ankimit, i cili shqyrton dhe jep vlerësimin përfundimtar për studentin. Komisioni raporton në përfundim të drejtuesit të departamentit. <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i>

Konkluzione	GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas takimeve të studentëve. Cdo kërkesë apo ankimin i tyre sa i takon vlersimit të njohurive, shqyrtohet nga komisioni vlerësimit me procedurë transparente dhe të dekumentuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktika, përmbajtja e tyre dhe metodat e mësimdhënies krijojnë mundësinë dhe garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve. Alternimi i lëndëve të formimit të përgjithshëm me ato të formimit karakterizues apo plotësues i ndihmon studentët të fitojnë dhe zhvillojnë aftësi profesionale në fushat e studimit që ofron ky program studimi, të cilat përforcohen edhe nëpërmjet laboratorëve dhe zhvillimit të praktikës profesionale. <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi"</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Bazuar në planin mësimor, programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Në kurrikulat e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi, studentët zhvillojnë disa lëndë me zgjedhje jo teknike si: Gjuhë Turke, Geriatri, Legjislacion, Imunohematologji, Etikë psikologji, që kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të tyre. <i>EVIDENCA 3.15. Korniza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.16. Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Stafit akademik në fund të semestrit analizon ecurinë e lëndës, rezultatet e arritura dhe parashikon ndërhyrje përmirësuese në varësi edhe nga rezultatet dhe sygjerimet e studentëve. Në përfundim të lëndës studentët zhvillojnë një detyrë kurse paraqitet në syllabusin e lëndëve, në të cilën prezantohen njohuritë e mara, si dhe kompetencat e fituara. Në përfundim të prezantimeve pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë dhe kompetencat e fituara. Në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, vlerësohen nëpërmjet provimit. Në FSHMT funksionon rregull i lëndëve penguese të cilat janë të ndërvarura dhe vazhdim i njëra-tjetres. <i>EVIDENCA 3.15 Komiza konceptuale e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i>

	<i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" për vitin akademik 2021 -2022.</i>		
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit konkludoi se mësimdhënia kryhet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që t'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar dhe praktikuar njohuritë e marra në laboratorët në dispozicion si: laborator i Anatomisë Digjitale dhe laborator i Fizioterapisë, për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale. Sikurse konstatohet dhe nga dekontacioni i dorëzuar, Departamenti i Lëndëve Paraklinike ka shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e mobilitetit ERASMUS +, ku studentët e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" të zhvillojnë një semestër në Univesitete me të cilat UNIEL ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë takimeve u konstatua se stafi akademik dhe studentët punojnë bashkë për projekte apo kërkim shkencor, duke mundësuar dhe botimin e punimeve të tyre në organe botimi apo buletine. <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i>		
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë takimit me personelin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë u konstatua se Departamenti i Lëndëve Paraklinike zhvillon leksione të hapura dhe workshop me tema të caktuara, mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe të teknologjisë duke ndarë eksperiencën e tyre me studentët. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. <i>EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i> <i>EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit</i>		
Konkluzione	GVJ konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, që zhvillon mësim në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>UNIEL paraqet një procedurë të qartë të miratuar për provimin final gjithëpërfshirës dhe diplomimit të studentëve. Ajo është pasqyruar edhe në rregulloret përkatëse të Universitetit. Gjithashtu UNIEL ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës dhe e ka publikuar atë.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i> <i>EVIDENCA 3.10 Manuali i punimit të diplomës</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni u konkludua se programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi akademik i Njësisë Bazë, propozohet nga drejtuesi i Njësisë Bazë, si dhe miratohet nga Dekani. Programi afishohet 2 muaj përpara provimit pranë FSHMT.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik rezultuan se komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. IAL nuk ka aplikuar asnjëherë provimin final me temë diplome, por gjithmonë me provim.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pas takimeve me stafin akademik GVJ konstatoi se, studentët janë në orientim të vazhduar nga stafi akademik për provimin e diplomës. Staf akademik I ndihmon studentët për çdo problematikë që ata hasin gjatë përgatitjes për provimin final.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës të laboratoreve GVJ konstatoi se institucioni i krijon mundësinë dhe i asiston me personel akademik dhe ndihmës akademik studentëve për kryerjen e ushtrimeve të praktikës, përdorimit të aparaturave specifike në laborator apo jashtë tij në bazë të temave të praktikës dhe fushës përkatëse të studimit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.35 Paketa e praktikës për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit rregullorja e diplomimit</i> <i>EVIDENCA 1.36 Rregullore e praktikës</i></p>



<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Komisioni i caktuar nga Rektori, me propozimin e Dekanit të Fakultetit të Fizioterapise, vlerëson në mënyrë të përshtatshme karrierën e studentit dhe merr parasysh vlerësimin e provimit dhe përfundon me një notë përfundimtare. Rezultatet e provimit final u jepen studentëve në fund të ditës së provimit. Në përfundim të procesit të provimit, Kryetari i Komisionit të provimit hedh rezultatet e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave. Procesverbali i gjeneruar nga sistemi EMS, nënshkruhet nga kryetari dhe një anëtar i komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe dorëzohet në sekretari. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Rezultatet e provimit final u jepen studentëve në fund të ditës së provimit. Në përfundim të studimeve studentit pajiset me listën e notave sipas planit të studimit të zhvilluar, suplementin e diplomes dhe diplomën, formati i së cilës është miratuar nga MASR. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi") EVIDENCA 1.29 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.30 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë takimit me sekretarinë mësimore GJV konstatoi se të gjitha dokumentat e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave të vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentore sipas periudhës së studimit. Në çdo kohë studentët kanë në dispozicion dokumente specifike që provojnë statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" EVIDENCA 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i>.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GJV konkludon se ky standard përmbushet plotësisht pas shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion si dhe vizitës në aktivitet. Programi i provimit përfundimtar të formimit është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Detyrimi permbylles bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 3-viteve akademike, duke patur informacion dhe përfshirë të gjitha lëndët në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. IAL nuk ka aplikuar asnjëherë provimin final me temë diplome, por gjithmonë me provim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar dhe pas intervistave me stafin akademik konstatoi se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për kualifikimin akademik, për drejtimin e programit, për angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, si dhe për fushën kërkimore apo eksperiencën praktike në përputhje meveçorinë dhe natyrën e modulit. GVJ konstatoi se DLP ka 11 anëtarë personel akademik me kohë të plotë ndër të cilët 1 me titull akademik Prof.as.dr, 5 personel akademik me gradën Doktor i Shkencave, 1 docent dhe 4 asistentë lektorë me gradën Msc, ndër të cilët 2 anëtarë janë në proces doktoreture. Gjithashtu në përbërjen e tij departamenti ka edhe 1 anëtar personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën Msc. Në personelin akademik me kohë të pjesshme departamenti ka 1 anëtar me gradën Prof.as.dr., 2 me gradën Dr. dhe 17 asistentë lektorë me gradën Msc. Raporti i tyre është i llogaritur me ngarkesën në orë mësimore sipas urdhrorit Nr.29 datë 10. 09. 2018 (Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL). (Evidenca 4.18 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" 2019-2020; 2020-2021, 2021 -2022).</p> <p>Tabela 2 Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Bachelor në Fizioterapi" në një vit akademik Tabela 7 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi" sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre Tabela 12 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</p> <p><i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën</p>	<p>Pas vlerësimit të dokumentacionit GVJ konkludoi se i gjithë personeli akademik (me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme) i angazhuar në</p>

<p>mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>zhvillimin e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi” përmbush kërkesat e legjislationit në fuqi. Çdo pedagog i personelit akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe gradën apo titullin shkencor dhe fushës që mbulon. Çdo fillim viti akademik pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit programet mësimore për modulet që do të mbulojnë</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 4.21 Plani i ngarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse)</i> <i>Tabelat 12 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës në programin e studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ konstatoi se UNIEL garanton dhe të dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, bazuar dhe në vezhgimin që GVJ ju beri dosjeve individuale të pedagogëve definitive dhe me kohe të pjeseshme, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p> <p><i>EVIDENCA 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e dosjes së vetëvlerësimit, faqen web të universitetit dhe në informacionin e siguruar nga vizita, GVJ konstatoi se Institucioni ndjek procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha njoftimet publikohen duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> <p><i>EVIDENCA 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL</i> <i>EVIDENCA 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik</i> <i>EVIDENCA 4.4 Rregullore e rekrutimit të personelit administrativ</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas</p>	<p>GVJ gjate takimit me stafin akademik dhe ndihmes akademik, konstatoi se sipas strukturës organizative të institucionit, UNIEL siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p>Vizita në institucion</p>

natyrës specifike të programit të studimit.	
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni dhe atij të marrë gjatë bisedës me UNIEL, konkludon se institucioni ka ngritur dhe ka funksionale strukturën përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit “Fizioterapi” e cila është Zyra e Burimeve Njerëzore. Në këtë strukturë, përcaktohen midis të tjerash llojin e dokumentacionit (në formë shkresore dhe/apo elektronike) që mbahet pranë institucionit dhe personin përgjegjës. Në lidhje me dokumentat që përmban dosja specifike e stafit akademik dhe administrative, institucioni vepron në bazë të udhëzimit për përmbajtjen e dosjes së stafit.</p> <p><i>EVIDENCA 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar u konstatua se institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit Bazuar në manualin e punimit të diplomës GVJ konstatoi se njësia bazë angazhon pedagogët për udhëheqjen e punimeve të diplomës apo në veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit, duke respektuar dokumentet rregullatore ligjore të njësisë bazë. Po kështu ne takimin me studentet u konstatua se me krijimin e Bordit Këshillimor të Biznesit, studentët janë përfshirë në aktivitete të shumta informuese për t’i njohur ata me kërkesat e punëdhënësve</p> <p><i>EVIDENCA 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave.</i> <i>EVIDENCA 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>U konstatua se personeli mbikqyrës përzgjidhet në mënyre rigorozë institucionale dhe angazhohet në mënyre aktive në përmbushjen e realizimit të praktikave profesionale në bazë të marrëveshjes/kontratës sepse një pjesë e personelit mbikqyrës të praktikave profesionale janë edhe staf akademik dhe ndihmës akademik me kohë të pjeshme pranë institucionit. Në fund studenti vlerësohet për pjesëmarrjen sasiore dhe cilësore aktive duke marrë edhe vlerësimin përkatës.</p> <p><i>Tabela 5-Institucionet dhe organizatat për mbushjen e detyrimeve bashkëpunuese në institucionet e tjera shtetërore.</i> <i>EVIDENCA 1.35 Plani e praktikës grafike të shpërndarjes së praktikave në spital) për programin e studimit “Bachelor në Fizioterapi”</i> <i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) “Bachelor në Fizioterapi”</i></p>

Konkluzione	GVJ konstaton se ky standart plotësohet pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. GVJ mendon se ky standart përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Godinat në të cilën zhvillohen aktivitetet mësimore dhe të tjera, të këtij programi studimi janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një realizim sa më profesional dhe eficient të detyrave nga personeli i angazhuar në këtë program. Dokumenti i vënë në dispozicion nga Institucioni pasqyron të dhënat infrastrukturore në funksion të programit të studimit. Ambjentet janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB si dhe në informacionin e marrë nga takimet me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi se mësimi zhvillohej gjatë ditëve të javës, në orarin 8.00-16.00. Studentët konfirmuan që leksionet dhe prezantimet e tjera zhvilloheshin duke përdorur edhe mjete audiovizive të cilat disponoheshin nga pedagogu i departamentit përkatës përgjegjës për mbulimin e lëndës <i>Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi infrastruktura dhe facilitetet për mesimdhënie ishin bashkëkohore: si hapësirat e nevojshme në funksion të programit të studimit “Fizioterapi” janë salla seminaresh, leksionesh, laboratorë dhe biblioteka. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor për të lehtësuar procesin mësimor. <i>EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të FSHMT.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve,	GVJ konkludon se institucioni disponon mjediset e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit specifik. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Në sallat e pajisura me mjete audio vizive u mundësohet studentëve paraqitja e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës.

aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<i>EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratoreve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit; EVIDENCA 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës).</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni konkludojmë se UNIEL ka siguruar të paktën një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale <i>EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të Fakultetit SHMT</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon UNIEL vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se UNIEL disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit <i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS. Njësia bazë disponon informacionin që lidhet me studentët mbi aktivitetin e ruhen në dokumentacionin e njësive bazë Tabela 21-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të	GVJ gjate vizites ne institucion si dhe dokumentat e vena ne dispozicion konstatoi se, FSHMT disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit (EMS dhe UNIEL.EDU.AL) nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin që lidhet me aktivitetin e personelit akademik, me kohë të plotë, të pjesshëm dhe të ftuar (regjistrave të kursit, marrëveshja e pedagogut evidencat për realizimin e ngarkesës mësimore), dhe personelit ndihmës akademik. Sistemi është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët, stafi akademik dhe stafi administrativ; stafi administrativ luan një rol kyç në përditësimin dhe hedhjen e vazhdueshme të të dhënave. Stafi akademik gjithashtu ka akses të dedikuar për menxhimin

gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	e lëndëve të zhvilluara dhe komponentëve të vlerësimit total të studentëve. <i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS.</i> <i>EVIDENCA 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB); Rregullore e UNIEL për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në UNIEL</i>								
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga takimi me studentët, GVJ konstanton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi ju dërgohen kryesisht përmes adresave të unifikuara të e-mailit. Sistemi i menaxhimit mundëson regjistrimin e lëndëve të studentit, i cili ndjek aktivitetin akademik të lëndëve përgjatë semestrit dhe gjenden të dhëna që nevojiten: orarin mësimor, vlerësimet, tarifat e studimit, etj. Sistemi i ofruar përmes platformës Moodle uniel.edu.al dhe platforma MS Teams realizon shkëmbimit të informacionit komunikimin interaktiv <i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS</i> <i>Vizita ne institucion</i>								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga intervistat me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se komunikimi bëhet kryesisht nëpërmjet adresave të e-mail (uniel.edu.al) me të cilat janë të pajisur i gjithë stafi akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshëm). Teknologjia e ka mundësuar raportimet individuale dhe të dhënave në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Sistemi i menaxhimit është lehtësues në raportimet e të dhënave në kohë për organet dhe autoritetet drejtuese, përmes llogarive personale të stafit akademik, të cilët kanë akses sipas rolit të tyre <i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS</i>								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	UNIEL publikon në faqen zyrtare informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme: njoftime per punesim, njoftime per konferenca te ndryshme, work shope, data sezoni, plane mesimore etj <i>EVIDENCA 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB</i>								
Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, dokumentat e vëna në dispozicion si dhe guidën në institucion mendon se UST, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni harton raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare në momentin e miratimit për hapjen e programit të studimit. Njësia bazë harton një raport financiar në fund të çdo viti akademik, si dhe planin për mbështetje financiare të njësisë në fillim të çdo viti akademik. Informacioni për raportimin financiar realizohet nga të dhënat që japin pedagogët sipas nevojave të tyre <i>EVIDENCA 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi", plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstatoi se buxheti i institucionit miratohet nga Bordi i Administrimit dhe shpërndahet për zbatim në të gjitha njësitë bazë. Fondet janë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit, të cilat shpërndahen sipas nevojave që paraqesin njësitë bazë për plotësimin e kërkesave të planifikuara. Çdo fillim viti akademik, njësia bazë paraqet kërkesat për nevoja në materiale në shërbim të realizimit të programeve, si dhe për mbështetje në kërkimin shkencor, duke pasqyruar parashikimet financiare të nevojshme për vitin akademik. <i>EVIDENCA 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022</i> <i>EVIDENCA 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve</i> <i>EVIDENCA 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi", plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi</i> <i>EVIDENCA 4.17 Kërkesa për parashikime financiare për buxhetin e vitit aktual (2020 dhe 2022) departamenti i Lëndëve Paraklinike.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UNIEL i nënshtrohet vazhdimisht auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacion e vene në dispozicion <i>EVIDENCA 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit, i cili bëhet me dije deri në nivelin e njësisë bazë dhe anëtarëve të njësisë bazë, njëkohësisht është i aksesueshëm dhe në faqen zyrtare <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UNIEL garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve <i>EVIDENCA 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022</i> <i>EVIDENCA 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve</i> <i>Vizita në institucion</i></p>

Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dhe referencat përkatëse Fmendon se institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga UNIEL vëren se pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në nivelin Bachelor bëhet në baze të rregullores së maturës shtetror dhe udhezimeve të here pas hershme të ardhura nga MAS. Po ashtu në përputhje me kriteret e pranimi dhe të përzgjedhjes, të miratuara nga statuti i Universitetit, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit 80/2015.</p> <p>Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, fushatat informuese në ditët e hapura, si edhe gjatë këshillimit në institucion. Studenti duhet të plotësojë kriteret e regjistrimit sipas procedurës përkatëse. Procedurat e regjistrimit kryhen sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve rregullatore.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.22 Vendim për miratimin e kuotave të pranimi për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 1.23 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimi për programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Tabela 21- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, si dhe për transferimin e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizites në institucion GVJ konstatoi se FSHMT nëpërmjet politikave dhe procedurave, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi". FSHMT ka të përcaktuara kriteret e pranimi të studentëve në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi". Aplikimi studentëve për pranimin në programet e studimit i jep barazi të gjithëve, për shkak të sistemit elektronik që përdoret. Pranë sekretarisë kryhet regjistrimi dhe studentet regjistrohen në sistemin EMS, ku ndjekin vijimësinë e tyre deri në diplomim</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve.</p>	<p>Në takimin me stafin pedagogjik dhe studentet si dhe dokumentat e vena në dispozicion, GVJ u informua dhe konstatoi se, para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "ditët e informimit të maturantëve" në gjimnazet kryesore të qarkut Elbasan dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në</p>

<p>Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>FSHMT. Staf i ngarkuar për informim organizon takime, shpërndan fletëpalosje ku sqarohen të interesuarit me informacionin e nevojshëm për kriteret e pranimit apo për çështje të tjera të lidhura me të.</p> <p>Nga ana tjetër kriteret e përgjithshme dhe ato specifike janë lehtësisht të aksesueshme në Web e UNIEL. Në fillim të çdo viti akademik realizohet procedura e regjistrimit dhe transferimit të studentëve. QSHA dhe RASH janë institucionet, që përgjigjen për pranimin në programet e studimit dhe transferimet. Faqja zyrtare e universitetit i jep mundësi studentëve të marrin kontakte për pyetje apo paqartësi të ndryshme. Institucioni parashikon dhe regjistrimin e studentëve të huaj sipas kriterëve të përcaktuara në kuadrin ligjor</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL.</i></p> <p><i>Tabela 21- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, si dhe për transferimin e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi").</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.30 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>Vizita nw institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjeshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në Web e UNIEL.</p> <p>Gjatë intervistës me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare (sistemi EMS) dhe QSHA, që japin informacione për çështje të ndryshme: procedurat e pranimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, vlerësimit të diplomimit</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i></p> <p><i>Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, si dhe për transferimin e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i></p> <p><i>Vizita ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UNIEL informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit Institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit, përmes portalit U albania dhe faqes zyrtare të univesitetit</p> <p><i>EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.</i></p> <p><i>Vizita nw institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta,</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara</p> <p><i>EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</i></p>

të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	<i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 1.16 Neni 32 rregullorja e Organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"</i> <i>Vizita nw institucion</i>		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se UNIEL harton dhe publikon kriteret dhe përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të vecanta <i>EVIDENCA 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.</i> <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL.</i>		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UNIEL <i>EVIDENCA 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet.</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>Vizita nw institucion</i>		
Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion mendon se UNIEL harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Fizioterapi.. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web si dhe takimit me përfaqësues të tij, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online EMS. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, përgatitja e punimit të diplomës, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturantët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me

	<p>drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturës, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore, sistemin EMS dhe njësinë bazë për të marrë informacion në lidhje me procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, si dhe për transferimin e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>U vlerësua se UNIEL informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme .</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se disponon dosjen personale (regjistrin) të çdo studenti që njihet me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit .</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar u konstatua se UNIEL ka hartuar rregulloren e studimeve dhe ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës dhe e ka publikuar atë në faqen zyrtare të institucionit , ku studentet marrin informacionin e duhur. Informimi i studentëve në lidhje me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit realizohet nga struktura e departamentit, i cili ka të hartuar manualin për kriteret e punimit të temës së diplomës. Ky material gjendet dhe në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>EVIDENCA 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 3.10 Manuali i punimit të diplomës</i> <i>EVIDENCA 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni se UNIEL organizon takime të hapura për informimin e maturantëve për programin e studimit UNIEL ka publikuar një spot promovues për programet e studimit që ofron dhe fletëpalosje promovuese. Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se UNIEL ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve</p>

interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara dhe marrin pjesë pedagogët e njësisë bazë. <i>EVIDENCA 5.2 Kalendar i ditëve të hapura 2022</i> <i>EVIDENCA 5.3 Publikimi i spotit promovues</i> <i>EVIDENCA 5.4. Fletëpalosjet promovuese institucionale</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin të karrierës.</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga UNIEL, konkludon se UNIEL vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UNIEL, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve në çdo fillim viti akademik nëpërmjet Njësisë bazë, sekretarisë mësimore dhe sistemit EMS <i>EVIDENCA 1.8. Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Fizioterapi. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet web-it. Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme edhe nëpërmjet LMS. Për studentët e vitit të dytë, marrin sërish informacion në momentin e përzgjedhjes së lëndës, nga pedagogu përgjegjës për këtë proces dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të EMS. Gjithashtu informacioni gjendet i publikuar në faqen WEB të institucionit, sipas

	<p>zërave përkatës. Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB). Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacione nga sekretaria mësimore nga faqja zyrtare, nga pedagogët për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Informacionet gjenden në stendat e holleve të universitetit. Departamenti ka të përgatitur udhëzues të përshtatshëm për mbrojtjen e diplomës.</p> <p><i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>EVIDENCA 4. 11 Rregulloria EMS</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.12. Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të UNIEL, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij. Me krijimin e Bordit Këshillimor të Biznesit, studentët janë përfshirë në aktivitete të shumta informuese për t'i njohur ata me kërkesat e punëdhënësve Studentët përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI janë dy zyra të institucionit të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Njëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale.</p> <p><i>EVIDENCA 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022.</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.5 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit.</i></p> <p><i>Tabela 23 -Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve..</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të UNIEL dhe FSHMT, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet web-it, sekretarisë mësimore dhe stafit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor.</p> <p><i>EVIDENCA 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratoreve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratoreve TIK të FSHMT</i></p> <p><i>EVIDENCA 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB</i></p> <p><i>Tabela 16 - Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë</p>	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstanton se UNIEL vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të EMS.</p>

lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<i>EVIDENCA 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Bachelor në Fizioterapi" në një vit akademik.</i> <i>EVIDENCA 4.12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për përmbajtjen e programit të studimit, objektivat, strukturën, organizimin, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan se Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë konstatuam se dhe kjo strukturë disponon dhe mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit dhe këto të dhëna gjenden në sekretarinë mësimore, si dhe në të dhënat dokumentuese të departamentit . <i>EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022,</i> <i>Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve,</i> <i>Tabela 23 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	FSHMT disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë "Fizioterapi" (ashtu sikurse për të gjitha programet e studimit që ofron), si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin EMS dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, nëpërmjet regjistrave të programit të studimit. Institucioni (sekretaria mësimore) mban dosjen personale të çdo studenti e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në institucion. Kjo dosje përditësohet edhe me elementë të tjerë si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, punimi i tezës së diplomimit si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

	<p><i>Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i></p> <p><i>Vizita ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Gjithashtu, u konstatua se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, sistemi EMS i departamentit, si dhe informacione në dekanat, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i></p> <p><i>EVIDENCA 4. 11 Rregullorja EMS.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se pranë njësisë bazë kryhen kontrole periodike për vlerësimin e gjendjes dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre dhe kjo arrihet përmes korrespondencës midis departamentit, sekretarisë, dekanatit dhe rektoratit.</p> <p><i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS</i></p> <p><i>Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.16 rregullorja e Organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë takimit me drajtuesin e Njësisë bazë dhe vizitave në institucion GVJ konstatoi se departamenti ndjek ecurinë e studentëve gjatë ciklit të plotë të studimeve, si dhe nivelin e fitimit të provimit të shtetit dhe licensimit falë bashkëpunimit që departamenti ka me UISH. Në varësi të nivelit të licensimit departamenti merr masa për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Njësia bazë harton raporte periodike analitike mbi cilësinë e hyrjes dhe daljes së studentëve, duke u përqendruar në vlerësimet e marra përgjatë viteve të studimit, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, që e siguron nëpërmjet Zyrës së ALUMNI-t, i cili realizon gjurmimin e studentëve. Të dhënat e mbledhura janë të vlefshme për Kalimin e politikave të njësisë bazë mbi përmirësimin e këtyre treguesve.</p> <p><i>EVIDENCA 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHMT për ngritjen e GVB 2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHMT,</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi për vitin akademik 2020-2021,</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve. Vizite nw institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, guidën dhe takimet në institucion mendon se ky institucion realizon një audit të brendshëm periodik, mbledh,</p>

	administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së, si dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se, UNIEL nxiti dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik UNIEL , në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre si dhe në Komisionin i Përhershëm për standardet e cilësisë dhe këshillimin e karrierës <i>EVIDENCA 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>EVIDENCA 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.</i> Vizite nw institucion
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ, konstatoi gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët konstatoi se UNIEL garanton përfshirjen e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në Senatin Akademik UNIEL në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre në Komisionin Institucional Zgjedhor si dhe janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit <i>EVIDENCA 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>EVIDENCA 5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor</i> <i>EVIDENCA 5.8 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional</i> <i>EVIDENCA 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL</i> <i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet</i> <i>EVIDENCA 5.11 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin Bachelor në Fizioterapi.</i> Vizite nw institucion
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin	Në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB dhe nga takimi me studentët arrijmë në konkluzionin se ata janë pjesëmarrës në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke përfshirë procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.</i>

e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<i>EVIDENCA 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor.</i> Vizite nw institucion			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar nga RVB, vizitës në institucion dhe takimit me studentët GVJ konkludon se personeli akademik ka në vëmendje barazinë dhe meritokracinë e studentit. Studentët u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ankimimin e rezultetit dhe reflektimin nga ana e institucionit/njesisë bazë dhe pedagogut përgjegjës . <i>EVIDENCA 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHMT për ngritjen e GVB 2022</i> <i>EVIDENCA 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i Lëndëve Klinike. Vizite nw institucion</i>			
Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion, takimin me stafin akademik dhe studentët mendon se ky institucion angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe ky anagazhim studentor rregullohet sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve , Statusit të UNIEL. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar nga RVB, si dhe bisedës me institucionin GVJ konkludon se UNIEL ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve siç është: sekretaria mësimore, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI dhe sistemi EMS të cilat janë në shërbim të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Institucioni vë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL.</i> <i>EVIDENCA I.16 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHMT-së, EVIDENCA 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL</i> <i>EVIDENCA 4.11 Rregulloria EMS.</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së, si dhe bisedës me institucionin vihet re se sistemi EMS është një sistem i posacëm për

<p>të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>informimin, këshillimin, ndjekje e përparimit të studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Në programet disiplinore të miratuara në departament janë të parashikuara oraret dhe klasat e takimit të studentëve me secilin pedagog për këshillime për lëndën dhe procesin mësimor.</p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 4.11 Rregullorja EMS</i> <i>EVIDENCA 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (syllabuset) "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së, si dhe vizitës në institucion u konstatua se Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve dhe ka një databazë të të dhënave të gjurimit të tyre, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit UNIEL ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve si: Sekretaritet, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) Komisioni i përhershëm institucional është krijuar dhe funksionon në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës si dhe Komisioni në nivel njësie kryesore për mbrojtjen e studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.</i> <i>EVIDENCA 5.17- Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A.Xhuvani"</i> <i>EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" 2020-2021/2021-2022.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB-së, si dhe vizitës në institucion GVJ evidenton se Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizojnë procesin e gjurmimit të studentit pas diplomimit, përpunon dhe mban të dhënat për punësimin e studentëve, me qëllim që të shërbejnë si informacion për studentët dhe autoritetet drejtuese të institucionit</p> <p><i>EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi" 2020-2021/ 2021-2022.</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i> <i>EVIDENCA 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A.Xhuvani".</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ mendon si konkluzion se UNIEL ka procedura , zyra, drejtori, e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, e janë lehtësisht të arritshme nga studentët .UNIEL falë këtyre zyrave bën të mundur ndjekjen e punësimit e tyre edhe</p>

	pas mbarimit të studimeve. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstatoi se metodat inovative dhe fokusi te studenti janë domosdoshmëri në praktikat institucionale të mësimdhënies në këtë institucion. UNIEL ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë <i>EVIDENCA 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se UNIEL ka ngritur drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila sipas legjislacionit në fuqi zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në UNIEL</p> <p>GVJ konfirmon se UNIEL, monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar rritjen e objektivave formuese dhe rezultat e vetësnuara të të nxënit</p> <p><i>EVIDENCA 5.9 Urdhëri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet.</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet</i></p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.13 Vendimi i FSHMT për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Cilësisë Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se pranë UNIEL është ngritur dhe funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të legjislacionit në fuqi zhvillon pyetësorin e studentëve, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, për matjen e performancës Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në UNIEL .Është ende duke u punuar mbi formën e trajtimit të ankimimeve. Gjatë vlerësimit u konstatua se në Komisionin e Përhershëm për Standardet e Cilësisë, një anëtar është përfaqësues i studentëve. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Gjithashtu, në website-in e UE-së, kërkesat për informacion dhe ankesat në rubrikën: Departamenti i Lëndëve Paraklinike ka hartuar pyetësorë për studentët për të marrë mendimet e gjykimet e tyre lidhur me format e metodat e mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve por edhe të njohjes me ankesat e studentëve.</p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i></p> <p><i>EVIDENCA 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet</i></p>

	<p><i>EVIDENCA 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet.</i> <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se pranë UNIEL është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës. Nga strukturat përgjegjëse hartohet një raport për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, në përmblyllje të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UNIEL-it. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë .</p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>EVIDENCA 1.20 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se NJSBC, vlerëson rezultatet e marra nga pyetësorët vlerësues të procesit të mësimdhënies nga studentët, raportin e analizës vjetore për fakultetin dhe universitetin, etj, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it. Veprimtaritë, praktikatat më të mira si: leksionet e hapura workshop-et dhe aktivitete të tjera në shërbim të formimit të studentëve publikohen si modele dhe shembuj përfaqësues në këtë faqe zyrtare . GVJ, gjatë vlerësimit konkludoi se FSHMT vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore në nivel departamenti. Personeli akademik plotëson skedën vetjake të vlerësimit të veprimtarisë shkencore, e cila dorëzohet dhe pasurohet çdo fundviti akademik.</p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022 Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se UNIEL ka një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilat ndihmojnë institucionin për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe performancën e stafit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konfirmon se UNIEL, disponon strukturën dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni103, Pika 1. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore vlerëson periodikisht veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore e shkencore. NJSBC zhvillon pyetësorët institucionale për matjen e performancës në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Pyetësoret realizohen dy herë në vit, para fillimit të çdo sezoni të provimeve. Gjatë takimit me stafin dhe drejtuesin e njësisë bazë GVJ konstatoi se Departa harton raportin vjetor, ku përfshihen të dhëna përshkruese mbi programin e studimit, stafin akademik, rezultatet e studentëve, kalueshmërinë dhe notën mesatare, të dhënat mbi veprimtarinë kërkimore e shkencore marrëveshjet e bashkëpunimit, literaturën e re të bibliotekës së universitetit, etj, <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022</i> <i>EVIDENCA 6.3 Urdhrrat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionale 2021 - 2022</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani".</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstatoi se Sistemi i Brendshëm i Cilësisë, funksionon si një rrjet i mirëorganizuar dhe shtrin funksionin e tij në të gjitha njësitë organizative të UNIEL. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, vepron në përputhje me Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë. Në FSHMT çdo anëtar i Komisionit të Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe Programeve të Studimit është përfaqësues i çdo njësie bazë të këtij fakulteti. UNIEL ka të angazhuar në cilësinë e personelit akademik të ftuar, të angazhuar në mësimdhënie, personalitete nga brenda dhe jashtë vendit <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit</i> <i>EVIDENCA 6.4 Lista e Personelit të Ftuar të angazhuar në FSHMT</i> <i>Tabela 22 - Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi".</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e</p>	<p>Nga Shqyrtimi i dosjes së dorëzuar të GVB, konstatoam se grupi ynë i akreditimit për programin Fizioterapi, është duke kryer procesin e parë të vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Ne konstatojmë se institucioni bashkëpunon me ASCAL dhe programet e studimit i nënshtrohen në mënyrë periodike procesit të akreditimit. UNIEL i është nënshtuar procesit të akreditimit institucional dy herë. Në vlerësimin e funksionit, akreditimi i tij ka qenë maksimal me 6 vite . Mekanizmat e përdorur për sigurimi i cilësisë janë proceset e pyetësorët për vlerësimin e studentëve, për vlerësimin e anëtarëve të stafit akademik si edhe vetëvlerësimi i</p>

përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	pedagogëve, por edhe përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësuarit. <i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>EVIDENCA 1.37 Raporti i vetëvlerësimit për akreditimin institucional</i> <i>EVIDENCA 1.3 Strategjia e UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1. I Statuti i UNIEL</i> <i>Vizita në institucion</i>		
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Gjatë vlerësimit GJVJ konstaton se në zbatim të akteve rregullatore, UNIEL përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve, të cilat kontrollohen nga NJSBC. NJSBC, në vazhdimësi mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore të disiplinave mësimore si edhe harmonizimin e tyre. Gjatë takimeve në institucion u konkludua se FSHMT dhe Departamenti i Lëndëve Paraklinike kanë përdorur disa metoda për realizimin e vlerësimit, si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin nga përfaqësuesit e dekanatit të FSHMT-së, leksione të hapura e degjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kqyrjes së praktikës, etj. <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022</i> <i>EVIDENCA 6.3 Urdhri për zhvillimin e pyetësorëve instifucionale, 2021 -2022</i> <i>TABELA 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve në programin e studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga Departamenti i Lëndëve Klinike</i> <i>EVIDENCA 1.40 Pyetësor studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, procesit mësimor dhe pëmbajtjen e kurrikulës në programin mësimor "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Vizita në institucion</i>		
Konkluzione	GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të vëna në dispozicion, guidës në UNIEL mendon se UNIEL, zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UNIEL. GJVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese	GVJ nga takimi me përfaqësues të institucionit konkludon se UNIEL ka të ngritur institucione që mbulojnë aspektet kurrikulare dhe ato të sigurimit



<p>formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>të cilësisë, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore aktualisht në fuqi, Statutit të UE dhe rregulloreve të Institucionit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron dhe vlerëson këto programe, duke kërkuar edhe garantimin e përbushjes së një sërë objektivave të nevojshëm për të tëra palët e interesuara, akademikët, studentët dhe shoqëria. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse, sikurse edhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve përgjegjës të departamentit, për të evidentuar arritjet apo dobësitë e vërejtura.</p> <p><i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani"</i> <i>EVIDENCA 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i> <i>EVIDENCA 1.33 Analiza vjetore e FSHMT 2020-2022</i> <i>EVIDENCA 1.34 Analiza vjetore e departamentit të Lëndëve Paraklinike 2021-2022</i> <i>Tabela 19 Veprimtari shkencore individuale të stafit akademik në funksion edhe të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi", në vitet e fundit.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Pas takimit me përfaqësues të institucionit GVJ konstatoi se Dekanati i FSHMT-së në përmblyllje të vitit akademik përgatit analizën vjetore të fakultetit duke ia dërguar Senatit të UE-së. Kjo bëhet pasi departamentet përkatëse, përbërëse të këtij fakulteti, sikurse edhe Departamenti i Lëndëve Paraklinike dorëzojnë analizat e tyre me rezultatet e vlerësimit dhe problematikat përkatëse. Komunikimi i këtij informacioni në Senatin e UE krijon një mundësi për ndryshimet e nevojshme dhe garantimin e rritjes së cilësisë së programit të studimit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës <i>EVIDENCA 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i> <i>EVIDENCA 1.33 Analiza vjetore e FSHMT 2020-2021, 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 1.34 Analiza vjetore e departamentit të Lëndëve Paraklinike 2021-2022.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara,</p>	<p>Pas takimit me përfaqësues të institucionit, GVJ konstatoi se metodat e përdorura përfshijnë instrumenta për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e marrëdhënieve me jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe strukturave të tjera të posaçme në fakultete e departamente pranë UNIEL, organizojnë punën, ndjekin dhe kontrollojnë procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planet mësimore e programet në zbatimin e tyre. Përgjegjësi i departamentit, ndjek rregullisht zbatimin e programeve të studimeve. Në fillim të vitit akademik Departamenti rishikon syllabuset dhe kurrikulën dhe nëse e gjykon të nevojshme propozon edhe ndryshimin e saj brenda masës 20% të saj, sidomos kur kjo mendohet se i shërben kërkesave të tregut të punës. Drejtorja e kurrikulave dhe strukturat përgjegjëse për</p>


<p>rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>vlerësimin e projekt programeve të paraqitura shqyrtojnë kërkesat e departamenteve. <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL, kreu VI</i> <i>EVIDENCA 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>EVIDENCA 1.14 Rregullore e departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>EVIDENCA 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave.</i> <i>EVIDENCA 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit "Bachelor në Fizioterapi" (në 3 vite)</i> <i>EVIDENCA 1.32 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve)</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani".</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentat e vëna në dispozicion dhe takimi me përfaqësues të tij se pranë UNIEL është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, mbledh dhe përpunon periodikisht të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Institucioni harton raportin final në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien e kërkimin shkencor si edhe cilësinë e shërbimeve që u janë ofruar studentëve dhe jepen rekomandime për përmirësimin e cilësisë. Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë u konstatua se Departamenti i Lëndëve Paraklinike zhvillon anketime/pyetësore me studentët, duke ruajtur anonimatën për zhvillimin e cilësisë mësimore. Të dhëna të tilla, duke përfshirë edhe kalueshmërinë e studentëve, ciësinë e mësimdhënies, e pedagogut, syllabuset dhe literatura etj, pergjegjësi i Departamentit të Lëndëve Klinike ia përcjell përmes Dekanit të FSHMT-së Rektoratit të UE-së. Rezultatet e tij bëhen të njohura dhe shërbejnë si një bazë orientuese për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit si dhe për rritjen e bashkëpunimit pedagog-student.</p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.</i> <i>EVIDENCA 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2022</i> <i>EVIDENCA 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHMT për ngritjen e GVB 2022</i> <i>EVIDENCA 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.33 Analiza vjetore e FSHMT 2020-2021</i> <i>EVIDENCA 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i> <i>EVIDENCA 1.34 Analiza vjetore e departamentit të Lëndëve Paraklinike 2021-2022</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ mendon se ky institucion e plotëson këtë standart pasi vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e</p>

	objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit dhe disponon raporte periodike të vlerësimit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ gjatë takimeve në institucion konstatoi se strukturat institucionale departament, fakultet, rektorat, planifikojnë organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Gjithashtu, u konstatua se veprimtaria e NJSBC rregullohet nëpërmjet rregullores së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e bazohet në legjislacionin në fuqi dhe Statutin e UE-së <i>EVIDENCA 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani"</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ konstatoi se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. UNIEL ka të përcaktuar në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij, detyrat konkrete për njësinë. Në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të institucionit dhe atë të NJSBC janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe detyrat për njësitë, individët studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Fizioterapi. <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe Funksionimit UNIEL,</i> <i>EVIDENCA 5.13 Vendim i FSHMT-së për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani"</i> <i>Tabela 24-Të dhëna për anëtarët e NJBSC.</i> <i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe	Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësim



<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>apo ndryshime në programet e studimit sipas Rregullores së UE, Rregullores së FSHMT-së, Rregullores së NJSBC. Gjatë takimit me studentët u konstatua se janë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Institucional në UE.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>EVIDENCA 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i> <i>EVIDENCA 5.13 Vendim i FSHMT-së për ngritjen e Njesisë se Sigurimit të Cilësisë</i> <i>EVIDENCA 5.16 Rregullore e NJSC të UE "A. Xhuvani</i> <i>EVIDENCA 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHMT për ngritjen e GVB 2022</i> <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia e zhvillimit të departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 1.40 Pyetësor studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, procesit mësimor dhe përbajtjen e kurrikulës.</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UNIEL. Kjo procedurë është transparente, publike, ruan anonimatin dhe nuk cënon integritetin akademik apo studentor.</p> <p><i>EVIDENCA 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL</i> <i>EVIDENCA 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe Këshillimin e Karrierës</i> <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Pas takimeve të ndryshme në insitucion GVJ konstatoi se një pjesë e rëndësishme e procesit të vlerësimit të brendshëm janë vlerësimet e të ish të diplomuarve, të ekspertëve, të bashkëpunëtorëve në hartimin e programeve të studimit apo syllabuseve. Në kuadër të akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit që mbulojnë departamentet e FSHMT-së, janë zhvilluar takime me grupin e Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas, të përzgjedhur nga ASCAL dhe Bordin e Akreditimit. Ata kanë zhvilluar takimet dhe verifikimet e nevojshme, duke përmbyllur një proces, i cili prej një viti kishte filluar në UNIEL</p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të RVB, dokumentave të ndryshme të vëna në dispozicion si guidës në institucion mendon se UNIEL përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e NJSBC-së të programit të studimit dhe informon institucionin në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikën që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UNIEL është i aksesueshëm nga i gjithë stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Gjatë takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pranë UNIEL është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Procesi për hartimin dhe vlerësimin e politikës së sigurimit të cilësisë, është gjithëpërfshirës i hapur dhe transparent për studentët dhe gjithë të interesuarit e tjerë. Në UNIEL dhe Departamentin e Lëndëve Paraklinike instrumenti më i përdorur lidhur me vlerësimin e cilësisë është "Pyetësori me studentët", që organizohet 2 herë në vit, për të gjitha lëndët dhe pedagogët në Departament. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe u vihen në dispozicion drejtuesve të FSHMT, institucionit, si dhe palëve të interesuara si dhe publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it. Këto veprimtari janë të pasqyruara në faqen zyrtare të UNIEL-it</p> <p><i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i> <i>Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar konstatohet se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Kanë miratuar rregulloren për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen e web publikohen të gjitha politikat dhe praktikën e sigurimit të cilësisë të cilat janë të aksesueshme për të gjithë. Gjatë hartimit të raportit respektohet liria dhe etika akademike, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi. GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar konstatoi disa mënyra të kryerjes së publikimit si psh: raportet e monitorimit u komunikohen strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve, raportet e vlerësimit të brendshëm e të akreditimit bëhen publike.</p> <p><i>EVIDENCA 3 .13 Informacion mbi politikën e zhvillimit dhe përmirësimit të kurrikulës</i> <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik</i> <i>EVIDENCA 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Nisur nga analiza e raporteve të vlerësimit, stafet angazhohen në plotësimin e rekomandimeve, ndjekjen e udhëzimeve për veprimet e marra. Masat, që synojnë përmirësimin e elementëve të evidentuara për rishikim, dokumentohen në formën e planeve të masave me qëllim përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë.</p>

	<p>Në zbatim të rekomandimeve angazhohet stafi akademik dhe ai ndihmës akademik. Raporti u dërgohet njësisë të tjera drejtuese të institucionit. Rezultatet e kontroleve të NJSBC mbi proceset akademike raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Kjo njësi, rekomandon detyra. Gjetjet dhe rekomandimet në çdo rast janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete. Në analizën e saj NJSBC-ja udhëzon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. Në raportin e NJSBC-së ka sugjerime/propozime përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë. Propozimet e NJSBC shqyrtohen nga organet dhe autoritetet drejtuese të institucionit dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.</p> <p><i>EVIDENCA 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>EVIDENCA 1.31 Raport për veprimtarinë e programit të studimit Bachelor në Fizioterapi për vitin akademik 2021-2022</i> <i>EVIDENCA 1.37 Raporti i vetëvlerësimit për akreditimin institucional</i> <i>EVIDENCA 5.12 Miratimi dhe funksionimi i programit të transparencës</i> <i>EVIDENCA 1.20 Strategjia për zhvillimin e programit të studimit</i> <i>EVIDENCA 1.18 Strategjia për zhvillimin e departamentit të Lëndëve Paraklinike</i> <i>EVIDENCA 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik</i> <i>EVIDENCA 1.17 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>EVIDENCA 6.2 Publikimi i Raportit 2021 -2022</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konkludon në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni se ai vlerëson dhe përpiqet për efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive për monitorimin e cilësisë me qëllim përmirësimin e programit të studimit, shërbimeve dhe performancës së personelit akademik e ndihmës akademik. Konkretisht, NJSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të UNIEL e për këtë harton raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Raportet, u bëhen të njohura strukturave përgjegjëse të Institucionit dhe i dërgohen MASR.</p> <p><i>EVIDENCA 1.32 Raport i fundit periodik analitik i pëfjitimeve nga marrëveshjet ebashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit "Bachelor në Fizioterapi"</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Mbledhjet e Asamblesë Akademike si dhe mbledhjet e Departamentit, përbëjnë mënyrat më të shpeshta të informimit mbi arritjet dhe problematikave; si dhe identifikimi i nevojave për ndërhyrje për përmirësim. Gjatë takimeve me stafin u konstatua se UNIEL organizon në mënyrë të vazhdueshme veprimtari me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin e përmirësimin afatgjatë të cilësisë si mobilitetet e ofruara për pedagogë dhe studentë të mbështetur financiarisht nga ERASMUS+. Gjatë takimeve me studentët u konstatua se ata marrin pjesë në trajnime, veprimtari kërkimore e shkencore, konferenca studentore, takimet me përfaqësues të ASCAL-it, etj. Këto veprimtari janë të pasqyruara në faqen zyrtare të UNIEL-it.</p>

	<p><i>EVIDENCA 6.4 Lista e personelit të ftuar e të angazhuar në FSHMT</i> <i>EVIDENCA 3.18 Të dhëna mbi stafin akademik dhe kërkimin shkencor</i> <i>EVIDENCA 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i> <i>EVIDENCA 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve</i> <i>Tabela 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Tabela 6.1; 6.2; 6.3</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ gjatë takimit me drejtues të UNIEL konstatoi se UNIEL organizon Politika të ndryshme të vlerësimit , dhe veprimtari për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat janë publike dhe transparente për të gjitha grupet e interesit. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Fizioterapi” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Pikat e forta:

1. UNIEL ka një përvojë tashmë pas disa vitesh në degët e mjekësisë.
2. Prania e laboratorëve të Anatomisë dhe veçanërisht Kabineti i Fizioterapisë me një sipërfaqe të mjaftueshme dhe pranisë së disa aparaturo bashkëkohore siguron efikasitet në aplikim praktik të njohurive teorike.

Pika te dobëta:

1. Plani i studimit nuk respekton plotësisht shpërdarjen e përqindjes së lëndëve sipas VKM NR.41 date 24.01.2018. **(standardi II.1, kriteri 1,3)**
2. Biblioteka nuk është e pajisur mjaftueshëm me tekste për fushën e Fizioterapisë në hard copy në dispozicion të studentëve. **(standardi II.4, kriteri 5)**
3. Institucioni haset në vështirësi në diversifikimin e burimeve të financimit dhe mbështet të projekteve shkencore apo trajnimeve të stafit akademik. **(standardi IV.5, kriteri 1,2)**
4. Institucioni nuk ka përgatitur nje analize të saktë për tregun e punës në vendin tonë, ku të dallohet nevoja për profesionistë në fushën e shkencave rehabilituese **(standardi II.1, kriteri 4).**

Rekomandime:

1. Të mundësohet nga institucioni përmirësimi i kurrikulave. Realizimi i programit Bachelor në “Fizioterapi” kërkon petagoge te rinj në disiplinat e shkencave rehabilituese për lëndet karakterizuese.
2. Te rishikohet shpërndarja e veprimtarive formuese në planin e studimit për kategoritë e lëndëve plotësuese – D dhe atyre përmblylëse -E në pëputhje të plotë me VKM nr. 41, datë 24.1.2018 të ndryshuar.
3. Biblioteka të pasurohet me literaturë mjekësore në vecanti në fushën e fizioterapisë, në gjuhën shqipe e të huaj me botime të viteve të fundit.
4. Të përdoret sistemi i Pitagorës sipas udhëzimeve të MAS.
5. Të përgatishë një analizë tregu pune të mirëfilltë.

Summary Conclusions of the External Evaluation Report, of the first cycle study program Bachelor in “Physiotherapy”, of the Higher Education Institution University of Elbasan “Aleksandër Xhuvani”

Strengths /Affirmations

1. UNIEL has an experience already after several years in the field of medicine.
2. The presence of Anatomy laboratories and especially the physiotherapy Cabinet with a sufficient area and the presence of some modern equipment, ensure efficiency in the practical application of theoretical knowledge.

Weaknesses

1. The study plan does not fully respect the distribution of the percentage of subjects according to VKM NO. 41 dated 24.01.2018 (**standard II.1, criterion 1,3**).
2. The library is not sufficiently equipped with books available to students, in field of physiotherapy in hard copy (**standardi II.4, criterion 5**).
3. The institution experiences difficulties in diversifying funding sources and supporting scientific projects or academic staff training (**standard IV.5, criterion 1,2**).
4. The institution has not prepared an accurate analysis for the labor market in our country, where can be identified the need for professionals in the field of rehabilitation. (**standard II.1, criterion 4**).

Recommendations

1. To enable from the institution the improvement of the curricula.
2. The realization of the bachelor program in "Physiotherapy" requires new academic staff in the disciplines of rehabilitation sciences for characteristic subjects.
3. To be reviewed the distribution of formative activities in the study plan for the categories of complementary courses - D and final courses - E in full compliance with VKM no.41 dated 24.01.2018.
4. The library should be enriched with medical literature, especially in the field of physiotherapy, in albanian and foreign languages with publications from recent years.
5. We suggest to the institution using of the Pythagoras system according to MAS guidelines.
6. We suggest to the institution a proper labor market analysis.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X